

MINISTRIA E ARSIMIT SPORTEVE DHE RINISË	MANUALI I PROÇESEVE TË PUNËS	KODI I PROÇESIT: 1-DF
		Versioni: 1.0
Përgatitur nga: DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR	Data: Mars 2019	

Emri I Proçesit	1. Planifikimi i Buxhetit
Nën- Proçesi	1.1 Buxheti Afatmesëm: përpunimi i buxhetit vjetor dhe shumë vjeçar (3 vjet) 1.2 Diskutime Buxhetore 1.3 Monitorimi i parasë / raportim periodic te Ministri 1.4 Rialokimi i fondeve të miratuara. 1.5 Investimet 1.6 Proçedura e prokurimeve në sistemin kompjuterik 1.7 Menaxhimi i fondeve të huaja (BB, BE...) 1.8 Planifikimi i Fluksit të Parasë
Njësia Përgjegjëse	Sektori i Buxhetit
Risqet Kryesore	<ul style="list-style-type: none"> - Mungesa e informimit të menaxherëve me eksperiencë në të gjithë sektorin e arsimit shpreh nevojën për MFK. - Drejtimes apo anëtarët e Grupit të Menaxhimit të Programeve, të jenë të pa trajnuar, të painformuar (i brendshëm), - Numer i pamjaftueshem i stafit, mund te sjelle vonesa ne arritjen e objektivave te arsimit krijon premisa per parregullsi (I brendshem) - Risku që Ekipe të Menaxhimit të Programeve të mos- plotësojnë sipas standardeve të MFE formularët e aplikimeve të buxhetit (I brendshëm); - Mungese ekspertize praktike, mund te sjelle vonesa ne aktivitetin në implementimin e projekteve dhe parregullsi (I brendshem); - Personel i pakualifikuar. Mund te cenoje efektivitetin e veprimtarise se MF te krijoje parregullsi dhe probleme ne menaxhim dhe standartet e kontrollit. (I brendshem); - Mungesë proçedurave/ manuale të shkruara, efektiviteti i kontroleve të brendshme. - Mungesa e të dhënave të grumbulluara dhe të përditësuara, për treguesit e arritjeve /indikatorë /produkte të realizuara në periudhat paraardhëse, si dhe në vitin aktual, në dispozicion të NA dhe NZ; - Përcaktimi jo i qartë i afatet kohore për realizimit e objektivave, produkteve, shpërndarja dhe cilësia e tyre brenda vitit buxhetor, - Shtirja dhe perspektiva shumëvjeçare në shpenzimeve për hartimin e politikave dhe buxhetimin. - Përbërja e rezultateve të shpenzimeve krahasuar me buxhetin e aprovuar,. - Nëse raportet financiare buxhetore përfshijnë shpenzimet të rëndësishme në aktivitetet e qeverisë qendrore, duke përfshirë edhe ato financime huaja apo financime nga donatorët. - Sigurimi se të gjitha shpenzimet duhet të alokohen para pagesës së tyre, me një autorizim të angazhimit të NA ose operatorit ekonomik të MAS. - Drejtuesit e EMP në MASR, nuk kanë një akses të drejtpërdrejtë në sistemin e të dhënave të Thesarit me qëllim monitorimin e realizimit të fondeve të buxhetit, parashikimi i buxhetit, rezultatet e arritura, autorizimin dhe pagimin e shpenzimeve. - Kontrollon shpenzimet pas ekzekutimit të buxhetit, pas përfundimit të procesit. - Risku që Institucione publike të sistemit arsimit të Lartë në emër të autonomisë së tyre të mos-plotësojnë sipas standardeve të MF formularët e aplikimeve të buxhetit (I brendshëm), - Risku që Njësitë e qeverisjes vendore, të mos paraqesin në MASR projektet e hatuara konform akteve ligjore dhe nenligjore të mirë-përgatitur, por i paraqesin direk në KZHR (I jashtëm); - Dobësi të vlerësuesve. Mund të ulet efektshmeria e procesit të selektimit të projekteve dhe cilësinë e implementimit të kontratave (I brendshem)

Përshkrimi i Proçesit

Planifikimi i buxhetit përcakton punën të nevojshme të Sektorit të Buxhetit në DBMF, në MASR, realizohet në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin e financave publike dhe raportimin mbi zbatimin e buxhetit të MASH.

MASR (Njësi e qeverisjes qendrore) përgatit kërkesat buxhetore në kuadër të Programit Buxhetor Afatmesëm, me qëllim që të sigurojë që shpërndarjet e fondeve buxhetore të reflektojnë qëllimet dhe objektivat e dokumentave strategjik të vendit, si dhe Programin e Qeverisë gjatë një periudhe afatmesme (3-vjeçare) duke bërë një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet shpërndarjes së buxhetit dhe objektiveve të politikës së programit

Ky proces përfshin shumë aktorë në nivel qendror dhe lokal të Ministrisë ;

- Drejtoritë e MASR
- Njësitë Arsimore Vendore;
- Institucionet arsimore;
- Institucionet publike të arsimit të lartë
- Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore;

Drejtimi i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MASR është i lidhur me MFE

MASR ka për të menaxhuar 6 programe të ndryshme :

1. Programi “Planifikim, menaxhim dhe administrim”
2. Programi “Arsimi Bazë”
3. Programi “Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm”
4. Programi “Arsimi i Lartë”
5. Programi “Kërkimi shkencor”.
6. Programi “Për sportin”.

Planifikimi/ Përgatitja e Buxhetit

Planifikimi i buxhetit fillon me kërkesat buxhetore nga agjencitë dhe departamentet. Këto kërkesa buxhetore konsolidohen në programet e ministrive. Menaxherët e të gjitha programeve formojnë ekip të menaxhimit. DBMF në mbështetje të Udhëzimeve të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë: “Për procedurat standarde për hatimin e buxhetit afatmesëm”, mbështet **Ekipet e Menaxhimit të Programeve**, që në mbështetje të detyrimeve kushtetuese, si dhe të akteve ligjore dhe nënligjore të:

- a) **Identifikon nevojën për buxhet për sistemin arsimor**, e cila buron nga programet dhe projektet;
- b) **Vlerëson nevojat buxhetore** në përputhje me prioritetet e ministrisë dhe politikat e strategjitë.
- c) **Menaxhon procesin e hartimit** të projektbuxhetit të ministrisë dhe të gjithë sistemit ministror dhe ia kalon Sekretarit të Përgjithshëm për miratim dhe procedim të mëtejshëm.
- d) **Menaxhon procesin e kërkimit** dhe garantimit të burimeve të ndryshme të financimit nga donatorë apo në partneritet me sektorin privat dhe ia propozon Sekretarit të Përgjithshëm për miratim dhe procedim të mëtejshëm.
- e) **Përgjegjës për menaxhimin e procesit** të optimizimit dhe shpërndarjes së burimeve të nevojshme financiare, sipas buxhetit të miratuar.
- f) **Siguron që burimet në dispozicion** të drejtorisë/ Ministrisë të organizohen në mënyrë që objektivat e saj të realizohen me efektshmëri të lartë, në mënyrë tërësisht të rregullt dhe korrekte.

DBMF, mbështet EMP, për të realizuara kërkesat buxhetore të çdo drejtorie /programi buxhetor/njësie të qeverisjes qendrore për hartimin:

- a. misionin e njësisë;
- b. përshkrimin e programeve;
- c. paraqitjen e qëllimit dhe objektiveve të politikës së programeve të shoqëruar me treguesit përkatës të performancës;
- d. planifikimin e shpenzimeve për çdo program sipas produkteve.
- e. treguesit faktikë për vitin buxhetor paraardhës, treguesit buxhetorë të planifikuar për vitin buxhetor në vazhdim, si edhe për tri vitet e ardhshme buxhetore;
- f. shpenzimet kapitale, listën e projekteve të investimeve për çdo program me:
 - i. koston e plotë të projektit;
 - ii. vlerën e financuar deri në fund të vitit buxhetor paraardhës;
 - iii. vlerën e parashikuar për t’u financuar në vitin buxhetor;
 - iv. vlerën e mbetur për t’u financuar në vitet pasardhëse buxhetore, burimet e financimit;
- g. një relacion shoqëruar për kërkesat buxhetore;
- h. Projektin e planit të arkës vjetor dhe të ndarë në muaj, si pjesë e projektbuxhetit vjetor dhe përfshin:
 - i. Fluksin e të ardhurave të parashikuara për t’u mbledhur dhe arkëtime të tjera;
 - ii. Planin e prokurimeve dhe angazhime të tjera të planifikuara;

	<p>iii. Pagesat e parashikuara që rrjedhin nga angazhimet.</p> <p>Në mënyrë që të përputhen me kërkesat e programit dhe me limitin e ministrive të buxhetit, ekipi i menaxhimit strategjik, për të cilin NA është koordinator, mbledhet me ekipin e menaxhimit. Si rezultat i këtij procesi negociator, Ministri/Titullari miraton tavanet buxhetore për programet. Nëse kërkesat buxhetore (më i lartë) nga programet janë të besueshme, Ministri do të përpiqet të negociojë për një tavan të lartë me Ministrinë e Financave. Nëse këto kërkesa janë të domosdoshme dhe në mbështetje të akteve ligjore, realizohen analiza dhe kërkesa shtesë drejtuar Ministrinë të Financave dhe Ekonomisë.</p> <p>Parashikimet e buxhetit janë të bazuara në rezultatet për vitet paraprake, vitet aktual financiar, si dhe janë të vlefshme për tre vitet e ardhshme.</p> <p><u>Implementimi dhe Realizimi i Fondeve të Buxhetit</u></p> <p>Detajimi i buxhetit për vitin ushtrimor, është mbështetur në Programin Buxhetor Afatmesëm, si dhe në prioritetet e përcaktuara në Programin e Qeverisë, si dhe objektivat strategjike. Detajimi i fondeve për vitin ushtrimor/ financiar, është realizuar sipas gjashtë programeve buxhetore ose niveleve arsimore ku janë mbajtur parasysh objektivat, qëllimi i synuar, përfituesit, në synim të objektiveve të programit të Qeverisë, objektiveve të përcaktuara në strategjinë e arsimit dhe Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2013-2020 dhe strategjinë e arsimit parauniversitar, si dhe kërkesave për implementimin e ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”</p> <p>Buxheti vjetor shpërndahet dhe në kuotave/tavanet mujore të shpenzimeve. Tavanet janë të përcaktuara nga ministria me miratimin e MFE. Buxheti i miratuar është shpërndarë, pasi të gjitha fondet/shpenzimet të miratohen së pari nga NZ dhe pastaj përmes NA të ministrisë, si dhe Nëpunësi i Parë Autorizues në Ministrinë e Financave.</p> <p><u>Raportimi</u></p> <p>Institucionet arsimore vendore (të gjitha institucionet e rajoneve), agjencitë, IAL publike raportojnë gjendjen e ekzekutimit të buxhetit të operatorit ekonomik të MASR. Agjencitë dhe drejtoritë rajonale dërgojnë raportet e tyre 4- mujore, 8-mujore dhe vjetore në drejtorinë e financave të MASR. Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar i konsolidon dhe dërgon ato te NA.</p> <p>Çdo 4-mujor, DBMF duhet të raportojë rezultatet në MFE. Rezultatet përfshijnë informacion financiar të tillë si buxheti i përgjithshëm, buxheti i shpenzuar dhe buxheti i mbetur. Raporti 4-mujor përshkruan edhe aktivitetet dhe performancën e secilit program. Sepse, NZ ka qasje të drejtpërdrejtë në sistemin e të dhënave të Kontabilitetit të MFE, ku krahason të dhënat me formatin e ofruar nga MFE. NZ është i detyruar të kërkojë të dhëna shtesë, nëse ai ose ajo ka nevojë për to në mes të dy raporteve 4-mujore. Pra, monitorimi është i bazuar në kontrollin manual.</p> <p>Në mënyrë që të përgatiten dhe konsolidohen raportimet, nuk ka asnjë sistem kompjuterik në MASR (Ministrinë të Linjës dhe agjencitë). Nga pikëpamja jonë, kjo është dobësia kryesore e këtij procesi. Prandaj, Ekspertët e huaj nuk e shohin këtë sistem dhe raportimin e këtij sistemi. Në mungesë të sistemit dhe angazhimit për autorizim të të dhënave të çdo shpenzimi (në detaje) në njësitë e shpenzimeve, NA kontrollon shpenzimet pas ekzekutimit të buxhetit (pas përfundimit të procesit). Dhe NZ ka vizion të vitit për t'i dhënë një raportim të konsoliduar për realizimin e fondeve për vitin ushtrimor.</p>
Njësi dhe struktura të tjera të përfshira në proces.	Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në MFE- së, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, Njësitë Arsimore Vendore, Institucionet publike të Arsimit të lartë, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (bashkitë).
Legjislacioni	<p>Baza ligjore për hartimin e kërkesave për financim me fonde nga buxheti i shtetit “Për realizimin e shërbimit arsimor publik” dhe hartimin buxhetit afatmesëm për periudhën 2019-2021 për Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë mbështetet në aktet sa vijon;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Neni 57 i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë - Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, - Ligji nr.10296, datë 08/07/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, - ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; - ligji nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; - ligji nr. 118/2016 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet vendeve të ballkanit përëndimor për ngritjen e zyrës rajonale për bashkëpunim rinor”; - ligji nr.109/2017, datë 30.11.2017 “Për buxhetin e vitit 2018”; - Vendimi nr. 505, datë 13.9.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë”; - Vendimi nr.11, datë 11.1.2016 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë së zhvillimit të arsimit parauniversitar, për periudhën 2014–2020”;

	<ul style="list-style-type: none"> - Vendimit Nr. 52, datë 27.1.2016 Këshillit të Ministrave “Për miratimin e programit të reformave ekonomike (erp) 2016–2018”; - Vendim nr. 710, datë 1.12.2017 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin, 2017-2022”. - Vendim nr. 175, datë 8.3.2017 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”. - Vendimi nr. 187, datë 8.3.2017 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”; - Vendimi nr. 268, datë 29.3.2017 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të këshillit të ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë”, i ndryshuar. - Vendimi nr. 202, datë 15.03.2017 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në Vendim nr.717, datë 23.6.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore” i ndryshuar; - Vendimi nr.399, datë 3.5.2017 të Këshilli të Ministrave “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”; - Vendimin nr.107, datë 10.2.2010 të Këshillit të Ministrave “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore, të sistemit arsimor parauniversitar” i ndryshuar. - Vendimi nr. 682, datë 29.7.2015 të Këshilli të Ministrave “Për përdorimin e fondeve buxhetore për transportimin e mësuesve dhe të nxënësve që punojnë e mësojnë jashtë vendbanimit”, i ndryshuar; - Vendimin nr.870, datë 14.12.2011 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” i ndryshuar; - Vendim nr. 329, datë 12.4.2017 i Këshillit të Ministrave ”Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik”; - Vendim nr.109, datë 15.2.2017 i Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të bordit të akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”; - Vendimin nr.607 datë 31.08.2016 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI); - Vendimi nr. 903 datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, i ndryshuar. - Vendimi nr. 185, datë 29.3.2018 i Këshillit të Ministrave “Për Procedurat e Menaxhimit të Investimeve Publike”. - Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.465, datë 18.07.2012 “Për integrimin gjinor në Programin Buxhetor Afatmesëm”; - Udhëzimit të përbashkët nr.21, datë 21.06.2013 “Për përcaktimin e procedurave për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm”, - Udhëzimi nr.7 datë 27.2.2018 i Ministrit të Financës dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm”. - Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 ”Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, - Udhëzimin nr. 22 datë 17.11.2016 të Ministrit të Financave “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”.
Kohëzgjatja	<p>Afatet për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm; Datat kryesore të Kalendarit të Menaxhimit të Shpenzimeve Publike për vitin, të detyrueshme për t’u zbatuar për qëllim të këtij Udhëzimi, janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Afati për dorëzimin e Kërkesave të Programit Buxhetor Afatmesëm, për Fazën strategjike (Faza e Parë), në të cilën përfshihen edhe propozimet për investimet publike, është deri më datë 1 maj të vitit ushtrimor/financiar; b) Udhëzimi Plotësues i Përgatitjes së Buxhetit, duhet të shpërndahet tek Njësitë e Qeverisjes Qendrore pas miratimit të draftit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm nga Këshilli i Ministrave, brenda datës 10 korrik të vitit ushtrimor/financiar; c) Afati për dorëzimin e Kërkesave të Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021 për fazën teknike (Faza e Dytë), është deri më datë 3 shtator të vitit ushtrimor/financiar; d) Datat e seancave dëgjimore të Programit Buxhetor Afatmesëm, për Fazën strategjike, paraqiten në Tabelën nr.2, bashkëlidhur këtij Udhëzimi. Në periudhat 17 Maj – 28 Maj, dhe 17 Shtator-26, Ministria përgjegjëse për financat do të zhvillojë seancat dëgjimore me të gjithë anëtarët e Grupeve të Menaxhimit Strategjik të Njësisë të Qeverisjes Qendrore . <p>Buxheti Vjetor, realizohet sipas afateve të përcaktuara në ligjin vjetor të buxheti, nga data 01 Janar deri në datën 31 Dhjetor, si dhe procedurave e standardeve të përcaktuara në aktet sa vijon:</p>

1. Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar,
2. Ligji nr.10296, datë 08/07/2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar,
3. Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 të Ministrit të Financave "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar.

Monitorimi dhe raportimi: Udhëzimin nr. 22 datë 17.11.2016 të Ministrit të Financave "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore",

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTEVE	MANUALI I PROÇESEVE TË PUNËS	KODI I PROÇESIT: X-XX
		Version: 1.0
Përgatitur nga: Financës	Drejtoria e	Data: DD/MM/AAAA

Emri I Proçesit	2. Kontabiliteti dhe prodhimi pasqyarve financiare të MAS
Nën- Proçesi	3.1 Kontabiliteti : shpenzimet dhe të ardhurat 3.2 Prodhimi i pasqyave financiare
Njësia Përgjegjëse	Sektori i Financës
Risqet Kryesore	<ul style="list-style-type: none"> - Sistemi i Kontabilitetit dhe llogaritë financiare shtetërore janë prodhuar mbi baza të parasë. Në këtë fazë, aktivet dhe detyrimet nuk janë mbajtur mbi bazaakruale. Shiko bilancin e 2014- ës - Fundi I Vitit: Duhet një a cut off betëeen the exercises (açounting years) is required. It seems not to have a procedure for this. - Nuk ka system kontabiliteti të kompjuterizuar. - Dokumentimi I gjurmëve të auditit. - Kohëzgjatja dhe rregullsia e rakordimit të të dhënave. - Koha dhe cilësia e pasqyave financiare sipas legjislaturës. - Proçedura të shkruara. - Efekasiteti I kontroleve të brendshme. <p style="color: red;">Të plotësohet</p>
Përshkrimi I Proçesit	Sektori ka si përgjegjësi plotësimin e pasqyave financiare të Ministrisë..
Njësi dhe struktura të tjera të përfshira në proçes	Drejtoria e Thesarit MoF Drejtori të MAS
Legjislacioni	Të plotësohet
Kohëzgjatja	Të plotësohet

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTEVE	MANUALI I PROÇESEVE TË PUNËS	KODI I PROÇESIT: X-XX
		Version: 1.0
Përgatitur nga: Financës	Drejtoria e	Data: 13/05/2015

Emri I Proçesit	3. Menaxhimi I Arsimit
Nën- Proçesi	Të plotësohet
Njësia Përgjegjëse	Të plotësohet
Risqet Kryesore	Të plotësohet
Përshkrimi I Proçesit	<p>Kjo drjtori është në hapjen e disa proçeseve buxhetore</p> <p>Kjo drejtori është e përfshirë në dy programe edukimi.</p> <p>Në nivelin e qeverisjes vendore ka:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 13 drejtori rajonale • 25 zyra arsimore
Njësi dhe struktura të tjera të përfshira në proçes	Të plotësohet
Legjislacioni	Të plotësohet
Kohëzgjatja	Të plotësohet